



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME**

---

A.A.br.27/2025

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Gjeriq, kryetare e kolegjit, Delushe Halimi dhe Nenad Laziq, anëtarë të kolegjit, lidhur me ankesën e subjektit politik: Levizja Vetëvendosje (L.VV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Sjelljes për subjektet politike, simpatizantëve dhe kandidatëve e tyre, gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, i cili do të mbahet më 09.02.2025, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A. nr. 194/2025 të datë 27.01.2025, n[ seancën e mbajtur më 03.02.2025, nxjerr këtë,

**A K T V E N D I M**

Hudhet poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, ushtruar kundër Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A. nr. 194/2025 i datës 27.01.2025.

**A r s y e t i m**

Me vendim të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr. 194/2025 të datës 27.01.2025, në pikën 1 të dispozitivit, është aprovuar si e bazuar ankesa e subjektit politik: Levizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, A.nr.194/2025 i datës 25.01. 2025.

Në pikën II të dispozitivit, subjekti politik: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, është gjobitur me 5.000.00 (pesë mijë euro) për shkak të shkeljes së Regullorës së sjelljes së subjekteve politike, të përkrahësve dhe kandidatëve të tyre.

Në pikën III të dispozitivit detyrohet subjekti politik: Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, që dënimin e shqiptuar nën pikën II të dispozitivit ta paguaj në afatin prej 15 ditëve nga data e plotfuqishmërisë së vendimit.

Kundër aktvendimit të cekur, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës, me të cilën konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të lartësisës së shumës monetare të shqiptuar në emër të dënimit, duke theksuar se e njëjta nuk është proporcionale dhe se është tejet e lartë. Gjithashtu, thekson se edhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) nuk i ka marrë parasysh të gjitha provat që janë dorëzuar, e të cilat para së gjithash kanë të bëjnë me kontratat e paraqitura për të drejtën e shfrytëzimit të objekteve.

Në përgjigje të ankesës, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka theksuar se ankesa nuk lejohet dhe ka propozuar që si e tillë e njëjta të hudhet poshtë.

Gjykata Supreme e Kosovës pas analizës së shkesave të lëndës dhe vlerësimit të lejuhmërisë së ankesës ka gjetur se:

Ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, kundër Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) A.nr 194/25 i datës 27.01.2025, nuk është i lejueshëm.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më 25.01.2025, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka pranuar ankesë nga subjekti politik Levizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ankesë pretendohet se më 25.01.2025, subjekti politik Levizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka identifikuar postera/pano të vendosur në vende/rrugë publike në të cilat gjenden kandidatë për deputet të subjektit politik Lidhja demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dhe atë: Lumir Abdixhiku, Berat Rukiqi, Jeta Rafuna-Hasani, Jehon Lushaku, Ismet Beqiri e të tjerë, në rrugën publike “Nazim Gafurri”, në Toukbahçe, si dhe postera/pano të vendosura në sipërfaqen publike/rrugët/sheshet ku gjendet kandidatja për zëvendës (LDK) Jehona Lushaku Sadriu, veçanërisht të vendosura në sheshin publik përballë Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, rruga “Luan Haradinaj” në Prishtinë.

Gjykata Supreme e Kosovës, gjatë ekzaminimit të ankesës nga aspekti i lejueshmërisë së saj, ka gjetur se ankesa nuk lejohet, për arsye si në vijim:

Neni 118 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në paragrafin IV përcakton: “Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAPja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës”.

Në kuptim të dispozitës së cekur të ligjit, meqë gjoba e shqiptuar nuk e kalon kufirin e përcaktuar me ligj, Gjykata Supreme e Kosovës të njëjtn e hodhi poshtë si të palejueshme vendosi si në dispozitiv.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**

AA.nr.27/2025, data 03.02.2025.

Kryetare e kolegjit - gjyqtare  
Milena Gjeriq

Përktheu: Drita Kelmendi